
TRIBUNA SINDIKALE

Nëntor 2007

Dhe drit' e diturisë përpara do na shpjerë





Editorial

TE CAKTOHEN E ZBATOHEN KRITERE RIGOROZE PER DREJTUESIT E SHKOLLAVE

Me hartimin dhe miratimin e Strategjise se Arsimit Parauniversitar jane vene baza te shendosha per te kryer nje reforme te suksesshme per modernizimin e arsimimit ne vendin tone. Sidomos me rritjen e GDP-se dhe buxhetit per arsimin, me rritjen e konsiderueshme te pagave te mesuesve ne sistemin parauniversitar, qe eshte bere keto dy vitet e fundit, dhe me cka eshte parashikuar ne buxhetin e vitit 2008, eshte nje hap i ndjeshem drejt objektivit madhor, jo vetem shqiptar por edhe Europian, per nje arsimcilesor publik dhe per shanse te barabarta per te gjithe.

Keto zhvillime, me tendece positive per te ardhmen e arsimit ne vendin tone, zhvillime qe jane rezultat edhe i kerkesave e dialogimit te vazhdueshem te sindikatave te arsimit me punedhenesin, me MASH dhe Qeverine dhe qe kane pasur e kane mirekuptimin e mbeshtetjen e sindikatave, mund te kompromentohen, e ne thelb, te sabotohen lehte nga veprime burokratike, nga mungesa e programeve pa vizion, pa kerkesa rigoroze e pa standarde qe zbatojne disa drejtori dhe zyra arsimore ne perzgjedhjen dhe emrimin e stafit drejtues te shkollave.

Per te fat te keq, eshte bere praktike, megjithese e paligjeruar, qe jo vetem kur zevendeshoet nje qeverisje me nje tjeter, sic eshte rasti i zevendesimit te koalicionit te majte me ate te djathte, por edhe brenda nje qeverisjeje, sapo emrohet nje Drejtor i ri i Drejtorise Arsimore Rajonale apo Zyres Arsimore ne rreth, veprimi i pare qe ben eshte largimi nga detyra i dhjetra e dhjetra drejtoreve e zevendesdrejtoreve te shkollave dhe zevendesimi i tyre me te tjere, pothuaj pa asnje aresye ose motiv.

Shembujt pa fund qe kane sindikatat e arsimit vertetojne se keto levizje kane aresye te shumta subjektive, miqesore, partiake, nderhyrjeje per t'u gjetur pune e poste militanteve, "forcim te autoritetit te drejtorit te ri", etj. Eshte e sigurte se ajo qe u mungon ketyre levizjeve e zevendesimeve te drejtuesve te shkollave, ne shumicen e rastev, eshte qellimi i mire per te permiresuar drejtimin dhe mbarevatjen e punes ne shkolle. Kete konkluzion e provon fakti se shumices dermuese te drejtuesve qe largohen nuk u jepet asnje motivacion ose argument, nuk u behet asnje vleresim pune. Nje pjese e mire e atyre qe largohen kane kryer trajnimet per drejtues, ndersa ata qe i zevendesojne nuk kane bere asnje lloj trajnimi.

Shume nga drejtuesit e shkollave, drejtore apo nendrejtore, jane prej atyre qe per me shume se 10 vjet kane qene te larguar nga arsimi, e kane braktisur profesionin, jane marre me biznes, kane sherbyer ne komuna, polici, SHISH, apo pune te tjera.

Megjithese ka akte nenligjore ne fuqi, te cilat mbeshteten ne standarde Europiane, sipas te cilave drejtuesit e shkollave perzgjidhen dhe emrohen me konkurs, askush nuk pyet per kete kuader ligjor.

Pyetja qe shtrohet eshte: A jane keto veprime njefare sabotimi i gjithe sakrificave qe ben qeveria, qe ben vendi, duke ndare fonde te medha nga buxheti i taksapaguesve per permiresimin e sherbimit ne arsimimin e brezit te ri, nga njera ane dhe i emrimit te shume drejtuesve te pa afte, qe nuk e meritojne nga ana profesionale e shpesh edhe morale besimin per ta drejtuar procesin e reformimit dhe modernizimit te arsimit ne Shqiperi?

Natyrisht, nuk eshte detyre e sindikatave dhe as drejtuesve te tyre qe te merren me emrimin e drejtuesve te shkollave. Por, si partnere sociale kryesore ne aresim, ato kane shume te drejte qe te ngrene zerin me force per hartimin dhe zbatimin e standardeve bashkekohore ne emrimin e drejtuesve te shkollave, qe ata te mos e pengojne, por ta cojne perpara procesin e reformimit cilesor te shkolles dhe te jene partner serioze e te pergjegjshem te sindikatave.

Kete ze sindikatat e arsimit e kane ngritur dhe do ta ngrene edhe me me force ne te ardhmen.

Xhafer Dobrushi
Kryetar i FSASH

PERMBAJTJA

- *Editorial:* Te caktohen e zbatohen kritere rigoroze per drejtuesit e shkollave 2
- Aktivitete te shumta ne zbatim te Projektit me FNV 3
- Aktivitete ne zbatim te Programit me EI-NOT 7
- Arsimi i Larte, baze per ndertimin e shoqerise se dijes, *nga A. Xhuvani* 10
- Eliminimi i punes se femijeve, objekt i rendesishem i SPASH, *(Nga mbledhja e Keshillit Kombetar dhe Komitetit Ekzekutiv te SPASH)* 11
- T'u pergjigjemi me mire shqetesimeve te sindikalisteve, *(Nga mbledhja me Seksionin e FSASH-it Tirane)* 13
- Zhvillimi strukturor i programit dhe kurrikulave të AFP në partneritet me aktoret e pushtetit vendor 14
- Te reja shkencore dhe keshilla praktike 15

Kopertina e pare:
Nje foto e perbashket me pjesemarresit, ne perfundim te seminarit me mesues, prinder e nxenes ne Bathore te Tiranes

Kopertina e fundit:
Grupi i valleve te shkolles "Ptoleme Xhuvani" ne Elbasan, ne aktivitetin e organizuar nga FSASH/SPASH ne kuadrin e Programit me EI-NOT

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 30, Periodike
Botim i FSASH dhe SPASH
Me mbeshtetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV
ADRESA PROVIZORE:
Pallati "TEKSTILISTI"
Lagja Kombinat, Tirane
Tel: + 355 68 20 34 674
+ 355 69 22 69 795
E-mail: fsash@icc-al.org
Internet: www.fsash-spash.com
Keshilli Botues:
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, **Kryeredaktor**

Aktivitete te shumta ne zbatim te Projektit me FNV

Pas pushimeve te veres, shtatori dhe tetori ishin muaj te nje pune te gjithanshme pergatitore dhe konkrete, duke organizuar aktivitete dhe duke mbajtur kontakte te aferta me drejtuesit lokale, si edhe me mesuesit e perfshire ne grupet e punes dhe nxenesit e perzgjedhur per te punuar individualisht, ne kuadrin e Projektit qe FSASH dhe SPASH jane duke zbatuar, ne bashkepunim me sindikatat holandeze, FNV dhe AOb.

Seminar treditor per punen me grate mesuese ne sindikate

Sic ishte planifikuar, Seminari me grate drejtuese lokale u organizua ne Tirane, ne datat 25, 26 dhe 27 tetor 2007.

25 pjesemarrese, nga te dyja sindikatat, FSASH dhe SPASH, pothuajse te gjitha drejtuerse lokale te komiteteve te grave te sapo krijuara, moren pjese ne kete seminar dhe punuan se bashku per tre dite me radhe, duke u perqendruar tek tema si te organizojme me mire grate mesuese ne sindikate.

Trajnueset tona, Ftabardha Keço, Elsa Peço dhe Lumturi Mataj punuan gjate dites se pare, ndersa trajnuesja holandeze Claire Oostvriesland u bashkua me to dhe drejtoi seminarin ne dy ditet ne vijim.

Te dy kryetaret e sindikatave tona, Xhafer Dobrushi dhe Bajram Kruja, moren pjese ne seminar dhe dhane kontributin tyre, vecanerisht gjate diskutimeve mbi problemet sipas tematikave, si edhe gjate perpunimit te programit te punes per te ardhmen.

Ishet e rendesishme qe seminari u organizua pas nje pune shume serioze dhe konkrete ne seksionet respektive per organizimin e komiteteve te grave dhe per permiresimin e situates ne lidhje me terheqjen e sa me shume grave mesuese ne sindikate.

Gjate tre diteve te seminarit ra ne sy aktivizimi i shumices prej pjesemarresve, ku mund te permenden sidomos: Mirela Karriqi, (Librazhd); Klodiana Qama, (Skrapar); Marsela Gurma, (Sarande); Nazmie Berisha dhe Feride Katana, (Tropoje); Mirela Shameti dhe Ortenca Mehmeti, (Delvine); Vasilika Bega, (Lushnje); Liri Pistja, (Kurbin); Stela Bazi, (Kavaje), Hyre Rexha, (Tirana rreth) etj.



Seminari ishte shume i rendesishem per te gjitha pjesemarreset. U trajtuan ceshtje te rendesishme teorike qe kishin te benin me rolin e grave mesuese ne sindikate, poziten e tyre ligjore dhe statutore, por, ne te njejten kohe, u diskutua edhe situata aktuale, puna qe eshte bere deri tani, problemet me te cilat ndeshen grate mesuese, synimet aftashkurtera dhe ato me afat me te gjate, si te organizohen me mire strukturat, si et perfitohet nga pervoja holandeze etj.

Vijon në faqen 4

Anketim mbi punen e veçante me grate mesuese

Ne vijim te aktiviteteve te mepareshme, filloi edhe puna konkrete per organizimin e anketimit ne lidhje me rolin e komiteteve te grave, te ngritura tashme prane seksioneve sindikale ne mbi 26 rrethe, dhe te vete sindikatave, per nje pune te vecante me grate mesuese, duke patur si synim qe te kontaktohen mbi 650 prej tyre, ne 65 shkolla te 13 rretheve te vendit.

Takimi i pare i 14 drejtueseve te ketyre grupeve u organizua ne Tirane, ne daten 25 shtator, ku u shpernda pyetesori dhe u diskutua mbi metodologjine dhe ceshtje te tjera qe kane te bejne me anketimin.

Kjo ceshtje ishte objekt edhe i seminarit te zhvilluar me grate drejtuese lokale te ketyre rretheve, me 25, 26 dhe 27 tetor 2007, ku mori pjese edhe nje ekspertja nga sindikata holandeze e arsimit, AOb, Claire Oostvriesland.

Seminar me drejtues seksionesh ne rrethe

Pas nje pune konkrete pergatitore, nje seminar i rendesishem u organizua ne Tirane, me pjesemarrjen e drejtuesve lokale te 10 seksioneve ku FSASH dhe SPASH jane duke punuar ne kuadrin e Projektit me FNV, me synim konsolidimin e mtejshem te tyre. 25 pjesemarres moren pjese ne seminar, i cili u konsiderua shume i rendesishem, jo vetem per trajnimin e ketyre drejtuesve lokale, por edhe si nje rast shume i mire per te diskutuar konkretisht ne lidhje me gjendjen aktuale, problemet me te cilat ata perballen, rolin e strukturave qendrore te FSASH e SPASH etj.

Lektoret Defrim Spahiu, Fatbardha Keco e Stavri Liko zhvilluan temat mbi kontraten kolektive te punes, rolin e grave mesuese ne sindikate dhe terheqjen e te rinjve ne radhet e sindikates.

Te dy kryetaret e FSASH e SPASH, Xh. Dobrushi e B. Kruja, prezent ne seminar, trajtuan ceshtje te rendesishme te rolit te drejtuesve lokale per organizimin e sindikatave, shprehen mendimet e tyre dhe bene sqarime ne lidhje me temat e diskutuara dhe problemet e ngritura nga pjesemarresit, sidomos per ceshtjet qe kishin te benin me qendrimet e padrejta te disa drejtorive dhe zyrave arsimore ndaj disa mesuesve qe kane mbaruar shkollen e mesme pedagogjike, per te cilen ka dale edhe nje Udhezim i dyte nga MASH.

Seminar treditor per punen me grate mesuese ne sindikate

Vijon nga faqja 3

Ekspertja holandeze Claire Oostvriesland ishte shume aktive gjate seancave plenare, por edhe gjate punes ne grupe ku u bene shume diskutime konkrete, si edhe gjate planifikimit te veprimeve konkrete, duke nxjerre edhe disa konkluzione ne lidhje me punen sindikale me grate mesuese.

Disa nga pikat kryesore te ketij plani ishin:

- Organizimi i seminareve te ngjajshme dhe aktiviteteve te tjera trajnuese me garte mesuese ne rrethet perkatese, nga ana e pjesemarreseve ne seminar,
- Organizimi i nje pune me konkrete per te rritur ne menyre te ndjeshme numrin e grave mesuese ne sindikate,
- Insistimi per permiresimin e legjislacionit dhe zbatimin e kontrates kolektive, ne lidhje me statusin e grave mesuese,
- Perpunimi i nje tematike konkrete ne lidhje me ceshtjet qe do te jene subjekt i seminareve te niveleve me te larta qe jane planifikuar te zhvillohen ne vijim me grate qe kane marre tashme trajnimin baze ne seminaret e zhvilluara gjate fazes se pare te projektit.

Duke qene prezente ne seminar, drejtueset e komiteteve te grave te FSASH e SPASH ne nivel qendror, paten kontakte te drejtperdrejta me grate drejtuese lokale dhe rane dakord per aktivitetet dhe veprimet konkrete qe do te ndermerren ne te ardhmen, sipas planit te veprimeve qe u miratua ne seminar.

Seminar me perfaqesues te prinderve dhe nxenesve per eliminimin e punes se femijeve

Seminari me pjesemarrjen e perfaqesuesve te prinderve dhe nxenesve nga Tirana (zona e kamzes) dhe Korca, dy rrethet me te cilat FSASH dhe SPASH jane duke punuar per eliminimin e punes se femijeve ne kuadrin e projektit me sindikaten holandeze, FNV, u zhvillua ne Tirane ne mesin e muajit tetor.

25 pjesemarres drejtues te sindikatave ne shkalle rrethi e shkollash, sidomos nga shkollat e perzgjedhura per te punar me konkretisht, si edhe perfaqesues te prinderve e nxenesve, moren pjese ne seminar, te cileve ne shkollen e Bathores iu shtuan edhe disa pjesemarres te tjere, si mesues, nxenes e prinder qe kane nje pervoje shume te mire ne punen per kthimin dhe ri integrimin e disa nxensve ne shkolle.

Shpjegimet teorike ne lidhje me te drejtat e femijeve sipas Konventes perkatese te Kombeve te Bashkuara dhe Konventave te ILO, Nr. 138 dhe Nr. 182, rendesine e arsimimit per te ardhmen e femijeve dhe te shoqerise, rolin e sindikatave per mobilizimin e anetareve te tyre per te siguruar arsim cilesor per te gjithe dhe per te eliminuar punen e femijeve; keto ishin disa nga ceshtjet kryesore qe u trajtuan nga drejtuesja e Njesise per eliminimin e Punes se Femijeve, qe funksionon ne kuadrin e Ministrise se Punes dhe Ceshtjeve Sociale, Znj. Shkelqesa Manaj.

Ajo prezantoi gjithashtu Manualin mbi Asrsimin Jo-Formal dhe Paketen e Moduleve SCREAM, te cilat jane botuar kohet e fundit nga FSASH e SPASH, me mbeshtetjen e ILO-IPEC ne Tirane. Situata aktuale ne te dy keto rrethe e me gjere, roli i vecante i sindikatave te arsimit, mesuesve, nxenesve dhe prinderve per te shmangur largimet e perkoheshme nga shkolla dhe braktisjen e saj, si nje parakusht per eliminimin e punes se femijeve, ishin disa nga ceshtjet me kryesore qe u diskutuan ne seminar.

Seanca e te shtunes e organizuar ne shkollen e Bathores, ne prezence edhe te disa pjesemarresve te tjere, mesues, prinder e nxenes, te cilet jane dukuar punar konkretisht me nxenesit qe kane probleme ne ndjekjen rregullisht te shkolles dhe rezultatet ne mesime.



Te dy kryetaret e FSASH e SPASH, zoti Xhafer Dobrushi dhe zoti Bajram Kruja, duke marre pjese aktive ne seminar dhane nje kontribut te drejtperdrejte ne zhvillimin e diskutimeve dhe perpunimin e programit te punes.

Diskutimet u bazuan tek te dhenat qe kane dale nga formularet e plotesuar, sidomos ne tete shkollat pilot te ketyre rretheve, duke folur per raste konkrete qe kane rezultuar me kthimin e disa nxenesve ne shkolle dhe parandalimin e disa te tjereve qe kishin filluar te benin mungesa te shpeshta.

Te gjithe pjesemarersit e konsideruan shume te vlefshem seminarin dhe premtuan vazhdimin e angazhimit te tyre per te plotesuar objektivat e caktuara ne kuadrin e Projektit, duke punuar se bashku; mesues, nxenes, prinder e perfaqesues te administratave te shkollave.

Riorganizimi i grupeve te mesuesve, prinderve e nxenesve, vecanerisht ne tete shkollat pilot, me synim qe te zgjerchet pjesemarrja e te gjitha aktoreve, ne nje te ardhme te afert dhe zgjerimi i bashkepunimit edhe me aktoret e tjere qe veprojne ne komunitet dhe me administratat e shkollave, si edhe rishikimi i funksionimit te Qeverive se Nxenesve dhe Komiteteve te Prinderve dhe rakordimi veprimeve me organet e pushtetit lokal, vecanerisht ne lidhje me zbatimin e ligjit per arsimin e detyrueshem, ishin disa nga pikat kryesore te programit te veprimeve qe u diskutua dhe miratua ne kete seminar.

Workshop mbi angazhimin e sindikatave shqiptare per eliminimin e punes se femijeve

Ne vijim te aktiviteteve ne kuadrin e Projektit me sindikaten holandeze FNV per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve dhe pas disa kontakteve e konsultimeve me perfaqesues te dy konfederatave, KSSH e BSPSH, dy sindikatat e arsimit, FSASH e SPASH, organizuan ne daten 5 tetor, nje workshop me pjesemarrjen e drejtuesve te disa sindikatave te degeve te tjera ne perberje te KSSH dhe BSPSH.

Drejtuesit kryesore te sindikatave te tekstilit, veshjeve dhe prodhimit te kepuceve; te industrise se lehte; bujqesise; tregtise; shendetesise, si edhe perfaqesues te keshillave sindikale te KSSH e BSPSH nga rrethet Tirane, Fier, Elbasan moren pjese aktive ne workshop. Megjithese te ftuar ne kohe, asnjeri nga te dy presidentet e KSSH e BSPASH nuk iu pergjigj kesaj ftese dhe, ndersa KSSH dergoi nje perfaqesues te vetin, punonjesin e sektorit te organizimit, askush nuk e perfaqesoi BSPSH, si strukture konfederative.

Ne prezence te te dy drejtuesve te FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, si edhe te disa drejtuesve te tjere lokale te ketyre sindikatave, diskutimet ne kete workshop u bene mbi bazen e nje dokumentacioni te pasur, perfshire materiale qe kishin te benin me soparimet pse puna e femijeve eshte nje ceshtje sindikale, cilat jane fusht ku mund te nderhyjne sindikatat per eliminimin e saj, konkluzionet e Konferences Kombetare te zhvilluar per kete ceshtje ne tetor 2004, Njesise per Eliminimin e Punes se Femijeve qe vepron ne kuadrin e Ministrise se Punes dhe Ceshtjeve Sociale, zoti Xhafer Dobrushi prezantoi situaten dhe permiresimet e nevojshme ne lidhje me kordinimin e punes midis sindikatave te arsimit dhe atyre ardhmen.

Dy drejtuesit e sindikatave te arsimit, Xhafer Dobrushi dhe Bajram Kruja, bene konkluzionet e seminarit dhe parashtruan disa nga drejtimet kryesore te punes se ketyre sindikatave ne kuadrin e zbatimit te keij Projekti.



sugjerimet e Konferences Rajonale, te zhvilluar ne tetor 2006, si edhe Rezoluten e Kongresit te Trete te KSSH mbi angazhimin e sindikatave per eliminimin e punes se femijeve.

Pas nje prezantimi te shkurter mbi situaten aktuale ne lidhje me punen e femijeve ne Shqiperi dhe nevojen per nje angazhim te te gjitha sindikatave per shmangien e ketij fenomeni, paraqitur nga Zj. Shkelqesa Manaj, drejtuese e te degeve te tjera, per nje veprimtari te suksesshme per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Duke marre pjese aktive ne diskutime, drejtuesit e sindikatave, si Minella Mano, Hajdar Kanani, Petrit Dajko, Alfred Xhomo, Tafil Gjolena, Luan Zonja etj, informuan per punen e bere dhe problemet qe dalin, duke bere edhe propozime konkrete per nje program veprimi per te

Disa nga konkluzionet kryesore qe dolen nga ky workshop jane:

-Te gjithe pjesemarresit veleresuan punen e bere nga dy sindikatat e arsimit dhe rezultatet e arritura per parandalimin e punes se femijeve dhe e konsideruan ate edhe si nje mision dhe obligim te seciles prej sindikatave qe ata perfaqesojne,

Vijon në faqen 7

Takime me mesues e nxenes ne kater rrethe dhe 16 shkolla

Takime efektive u organizuan me Grupet e Punes qe funksionojne ne shkalle rrethi ne Tirane, Elbasan, Fier dhe Korce, si edhe ne shkollat pilot te ketyre rretheve. Pjesemarres ne keto takime, te dy kryetaret e sindikatave, z. Xhafer Dobrushi dhe Z. Bajram Kruja, takuan me shume se 80 mesues e nxenes, ne 8 shkolla.

Mesuesit informuan se, bazuar tek problemet qe kane dale nga plotesimi i pyetesore, ata jane duke punuar me nxenesit e perzgjedhur ne cdo shkolle dhe do te vazhdojne te punojne me ta, jo vetem ne shkolle, por edhe jashtë saj, ne kontakte me prinderit dhe me partneret e tjere te angazhuar ne ceshtjen e parandalimit dhe eliminimit te punes se femijeve.

Vijon nga faqja 6

-U propozua qe te shikohet mundesia e nenshkrimit te nje marveshjeje specifike midis te gjitha sindikatave qe kane pranuar tashme angazhimin e tyre per eliminimin e punes se femijeve,

-U propozua, gjithashtu, qe te behen te gjitha perpjekjet qe te perfshine konkretisht ne kete pune edhe organizatat e punedhenesve, si edhe te angazhohen me mire Inspektoriati Shteteror i Punes dhe organet e tatim-taksave, duke synuar edhe nenshkrimin e nje marrveshje me perfaqesuesit e ketyre organeve.

-Disa pjesemarres informuan per angazhimet e deritanshme ne kuadrin e bashkepunimit me Inspektoriatin Shteteror te Punes dhe sindikaten holandeze FNV, (duke permendur edhe angazhimin e perfaqesuesit te Konfederates Nderkombetare te Sindikatave, z. Samuel Grumiau, ne emer te FNV).

-Te gjithe pjesemarresit rane dakord qe te caktojne nga nje perfaqesues te sindikatave respektive qe ndjek nga afer te gjitha detyrat qe kane te bejne me eliminimin e punes se femijeve, duke kerkuar qe te shikohet mundesia e kualifikimit te tyre, ndoshta nepermjet nje bashkepunimi me ILO-IPEC ne Tirane.

-Shume i rendesishem u konsiderua roli i medias ne lidhje me keto probleme dhe u ra dakord qe te permiresohen ndjeshem kontaktet, si me median e shkruar, ashtu edhe me ate elektronike, ne lidhje me aktivitetet qe kane te bejne me parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Te gjitha keto propozime e sugjerime do te perpunohen ne bashkepunim me drejtuesit e sindikateve te tjera dhe do te pergatitet nje draft programi veprimi, i cili do t'u paraqitet te gjitha sindikatave per te synuar angazhimin e sa me shume prej tyre ne kete ceshtje shume te rendesishme qe ka te beje me te ardhmen e femijeve tane, por edhe te vete vendit tone, duke synuar, gjithashtu, disa rezulatte konkrete deri nga marsi i vitit te arshem, kur do te mblidhet perseri nje Tryeze e Rrumbullakte, me pjesemarrjen e dhe te disa aktoreve te tjere te angazhuar ne kete ceshtje, per te diskutuar ne lidhje me ecurine e kesaj pune dhe detyrat per me tej.

Aktivitete ne zbatim te projektit EI-NOT

Aktivitetet ne zbatim te projektit me EI-NOT po zhvillohen me efektivitet.

Shume aktivitete u organizuan ne te 6 shkollat ku FSASH dhe SPASH jane te fokusuara, duke filluar nga dy shkollat e Elbasanit e Korces dhe me pas, edhe ne ato te Tiranes, (Bathore). Te dy kryetaret e sindikatave, Xh. Dobrushi dhe B. Kruja, moren pjese ne te gjitha keto aktivitete. Perfaqesuesi i Ministrise se Arsimit dhe Shkences, Z. Fatmir Bezati, mori pjese ne mbledhjen e Komitetit te Monitorimit te Punes se Femijeve, organizuar ne ambientet e Ministrise, per shkak te situates, pas nxjerrjes se paligjshme te sindikatave nga zyrat e tyre ne Tirane, ndersa perfaqesues te drejtorive arsimore te ketyre rretheve moren pjese ne takimet qe u zhvilluan ne disa shkolla.

Dy ishin ceshtjet kryesore qe u diskutuan ne keto takime:

1. Gjendja ne lidhje me punen konkrete qe eshte duke vazhduar me nxenesit e perzgjedhur. Mesuesit informuan se, bazuar ne problemet qe kane dale nga pyetesoret e plotesuar qe perpara pushimeve verore, ata po punojne me nxenes te vecante ne shkollat dhe klasat respektive dhe do te vazhdojne te punojne, jo vetem ne shkolla, por edhe jasht tyre, ne bashkepunim me koleget e tyre, sidomos mesuesit kujdestare, por edhe jasht shkolles, ne komunitet e deri ne familje, ne bashkepunim me partnere te tjere te angazhuar ne kete pune. Atyre iu kerkua qe te shkruajne informacione te shkurtera mbi punen qe ata jane duke bere dhe rezultatet qe po arrijne, me qellim qe ato te jene si shembull, jo vetem per koleget e tyre ne shkollat perkatese, por edhe jashte tyre ne shkalle rrethi e me gjere. Disa shembuj pozitive jane bere tashme te njohura, sidomos ne shkollen "Ptoleme Xhuvani" ne Elbasan, ne shkollen Bathore Nr.1, Tirane dhe ne shkollen e Liqenasit ne Korce, ku disa nxenes po e ndjekim me rregullisht shkollen dhe po arrijne rezultate me te mira ne mesime.

2. Pergatitja e aktiviteteve te planifikuara ne shkollat e perzgjedhura. Me te rendesishme midis tyre ishin aktivitetet sportive dhe kulturore, planifikuar per t'u zhvilluar ne Elbasan me 22 tetor, ne Korce, me 23 tetor dhe ne Tirane (Bathore), me 24 tetor. Pas diskutimeve konkrete, u ra dakord qe ato te organizohen ne forme garash midis dy shkollave te cdo rrethi, me pjesemrrjen e te gjithe nxenesve te perzgjedhur, por duke perfshire edhe disa nxenes te tjere, sidomos ne Bathore, ku nxeneset e perzgjedhura jane vetem vajza, duke planifikuar te pakten tre aktivitete sportive dhe po kaq kulturore, duke organizuar edhe shpalljen simbolike te fituesve ne nje koktejl qe do te organizohet me kete rast.

Grupe te vecanta pune, ku jane te angazhuar, gjithashtu, te gjithe mesuesit e ketyre shkollave, ndoqen nga afer pergatitjen e ketyre aktiviteteve.

Ne keto takime u diskutua, gjithashtu, edhe ne lidhje me pergatitjen e Tryezes se Rrumbullakte, planifikuar per t'u organizuar me 14 dhjetor, ku do te diskutohet, do te nxirren konkluzione dhe do te perpunohet e miratohet nje program pune per te ardhmen. Mendimi eshte qe kjo Tryeze te organizohet ne Tirane, per shkak te ambienteve dhe te mundesise se pjesemarrjes se perfaqesuesve te Ministrise, te institucioneve te tjera, si edhe te medias qendrore. Eshte i rendesishem fakti qe ne te tre keto rrethe, FSASH e SPASH po punojne per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, edhe ne kuadrin e Projektit me FNV, nje faktor tjeter ky qe siguron se kjo pune do te vazhdoje edhe pas perfundimit te Projektit te EI-NOT.

Ministri i Arsimit dhe Shkences, duke u informuar nga te dy kryetaret, ne nje takim qe ata kishin ditet e fundit ne ministri, mbi punen qe kane bere e po bejne sindikatat e arsimit per eliminimin e punes se femijeve, ka vleresuar angazhimin dhe rezultatet e arritura dhe ka premtuar me shume mbeshtetje, edhe per problemet e tjera qe jane ngritur gjate takimeve me mesuesit dhe nxenesit ne keto shkolla.

Aktivitete te shumta k







Sic ishin planifikuar, aktivitetet kulturore dhe sportive, ne zbatim te programit me Federaten nderkombetare te Arsimit EI dhe fondacionin holandez NOT, u organizuan me pjesemarrjen e nxenesve te shkollave perkatese, ne Elbasan, (shkollat "Ptoleme Xhuvani" dhe "De Rada", te henen, me 22 tetor, ne Korce, (shkollat Liqenas dhe Gorice), te marten, me 23 tetor dhe ne Tirane, (shkollat Bathore 1 dhe Bathore 2), te merkuren, me 24 tetor .

Me shume se 225 nxenes, perfshire te gjithe nxenesit e selektuar per te punar konkretisht ne keto shkolla, ne kuadrin e ketij Programi, moren pjese ne me shume se 10 gara sportive dhe aktivitete kulturore, duke perfshire futboll, volejboll, atletike, terheqje litari dhe lojra te tjera popullore, si edhe kenge, valle, recitime, pikture etj.

Te gjithe mesuesit e perfshire ne projekt, rreth 50, si edhe mjafte mesues te tjere, kryesisht specialiste te ketyre fushave, ishin organizatoret e ketyre aktiviteteve, te mbeshtetur nga drejtuesit e shkollave.

Ne aktivitete moren pjese, gjithashtu, kryetari i SPASH, Bajram Kruja dhe Zv/Kryetari Defrim Spahiu, si edhe perfaqesues te drejtorive arsimore te rretheve perkatese.

Aktivitetet u zhvilluan ne fome garash midis dy shkollave te secilit rreth. Komisione te vecanta i ndoqen ato nga afer dhe







kulturore dhe sportive





percaktuan fituesit, te cilet u shpallen ne ceremoni te posacme te zhvilluara ne koktejlet qe u dhane nga dy disa dhurata simbolike, si topa futbolli, voljebolli, basketbolli, hendbolli, rrjeta volejbolli, kuti shahu etj.



sindikatat e arsimit me kete rast, duke dhene Kupen per shkollat me te mira, Diploma per ekipe dhe individe te dalluar, si edhe

Vertete mbreselenese ishte kur te gjitha pane te jene pjesemarres ne keto aktivitete disa nga nxenesit qe e kishin braktisur shkollen ose po e ndiqnin ate me hope dhe ishin kthyer ne shkolle, si rezultat i nje pune konkrete qe kane bere te gjithe se bashku; mesues e nxenes, sic ishte rasti i nxeneses Daniela Lushnjari, e cila u nderua me diplomen si kercimtarja me e mire.

Ishte shume e veshtire te dalloje se cila shkolle ishte me e mire "Ptoleme Xhuvani" apo "De Rada", ne Elbasan, Liqenasi apo Gorica ne Korce, Bathore Nr.1 apo Bathore Nr.2 ne Tirane.

Shume nxenes u shpallen fitues ne disiplina te ndryshme, duke marre edhe Diplomat perkatese, midis te cileve mund te permenden : Esmeralda Peqini, Gani Metani, Hyqmet Cerriku, Lediana Peqini, Silvana Hysa, Blerim Sefa, Medina Cera, Elona Sokoli, dhe shume te tjere.

Eshte shume e rendesishme te theksohet se organizimi i ketyre aktiviteteve ishte vleresuar shume seriozisht nga mesuesit, nga vete nxenesit dhe nga drejtorite e shkollave, gje qe, krahas te tjerave, eshte edhe nje shembull se cfare mund te bejne vete shkollat per organizmin e me shume aktiviteteve te tilla, mbasi disa nga pjesemarresit u shprehen se ishte hera e pare qe shihnin nje konkurence kaq te madhe ne aktivitete te tilla.

Natyrisht te gjitha keto ceshtje dhe eksperienca do te mbahen parasysh per t'u diskutuar edhe ne tryezen e rrumbullakte qe pritet te organizohet ne kete kuader ne Tirane, ne drejtor te ketij viti.





Arsimi i Larte, baze per ndertimin e shoqerise se dijes

Mbështetur në rekomandimet e kryeministrave Evropianë, shpalosur në mbledhjen e tyre të Brukselit në Mars 2005 si edhe në nevojat e sistemit të Arsimit të Lartë (AL), Qeveria shqiptare ka vendosur të bashkojë përpjekjet e saj me ato te komunitetit akademik, politikëbërës dhe të aktorëve socialë për vënien në jetë të aspekteve themelorë të Procesit të Bolonjës, për realizimin e një reforme të thellë me pikësynim për ta kthyer arsimin e lartë të orientuar drejt tregut të punës, më social dhe një bazë të sigurt për ndërtimin e shoqërisë së dijes.

Tregues i qartë për këtë është edhe angazhimi real i aktorëve shqiptarë të arsimit të lartë në këtë proces të konceptimit dhe të riformulimit për :

- zhvillim kurrikular në institucionet e arsimit të lartë (IAL) sipas standardeve Evropiane,
- sigurim të cilësisë në IAL,
- njohje të titujve universitarë dhe formimeve të arritura gjatë gjithë jetës, një kornizë kombëtare të kualifikimeve,
- menaxhim autonom të përgjegjshëm dhe efikas të IAL që realisht filloi në Prill 2006, kohë kur i pari delegacion shqiptar i dedikuar mori pjesë në mbledhjen e radhës të Grupit Evropian për Ndjekjen e Procesit të Bolonjës – BFUG në Vjenë.

Qysh prej asaj kohe janë hedhur hapa të rëndësishëm në këto drejtime edhe me ndihmën dhe nën presionin e Këshillit të Evropës. Dy muaj më vonë, me një urdher të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, u krijua një grup i gjerë kombëtar për Ndjekjen e Procesit të Bolonjës – BFUG Albania, për udhëheqjen e tërë procesit të reformës universitare, i cili u nda ne tre nën grupe, puna e të cilëve do të përqendrohej në tre akse kryesore:


- Zhvillimi i kurrikulave dhe standardeve të mësimdhënies në IAL;
- Korniza Kombëtare e Kualifikimeve;
- Informimi i studentëve dhe njohja e titujve dhe formimeve.

Në këtë grup të ndjekjes së Procesit të Bolonjës bënin pjesë ekspertë të AL, pedagogë dhe drejtues të organizmave akademikë, studentë, partnerë nga bota e biznesit dhe aktorë socialë.

Një nder detyrat kryesore të këtij Grupi, është hartimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), e cila nuk ekzistonte më parë si e tillë, duhet të ishte padyshim në sintoni me direktivat Evropiane. Mungesa e eksperiencës në këtë fushë çoi në një nisje të projektit të hartimit të KKK me një mbledhje të organizuar në Korrik 2006 me ekspertët më me zë Evropiane të fushës dhe një grupi të gjerë specialistësh dhe akademikësh shqiptarë. Për më shumë, me anë të një buxheti të vogël të dedikuar të MASH-it disa akademikë shqiptarë morën pjesë në disa takime rajonale dhe kontinentale për shkëmbim eksperience mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe ato kombëtare.

Mbështetur në sa më sipër nën grupi shqiptar KKK vendosi piketat e para, mbi të cilat do të mbështetej procesi i hartimit të saj:

- përfitimi nga përparësitë e modeleve Evropianë, që tashmë janë hartuar dhe aprovuar nga autoritetet e vendeve respektivë;



Niveli i parë para universitar - përfundues të arsimit të detyruar
Niveli i dytë para universitar - përfundues të arsimit të detyruar dhe në shkollë të mesme
Niveli i tretë para universitar - përfundues të arsimit të mesëm
Niveli i katërt para universitar - përfundues të arsimit të mesëm dhe profesional
dhe:
Niveli i parë universitar Maturë + 1 ose Maturë +2 (vërtetime ose certifikata profesionale)
Niveli i dytë universitar Maturë +3 (Diplomë e nivelit të parë – 180 ECTS)
Niveli i tretë universitar Maturë +4 ("Bachelor" me meritë – 240 ECTS)
Niveli i katërt universitar Maturë +5 (Diplomë e nivelit të dytë >= 300 ECTS)
Niveli i pestë universitar Mature +8 (Diplomë e niveli të tretë - Doktor i Shkencave >= 360 ECTS)

- hartimi i një kornize që të përmbajë të 8 nivelet Evropiane si edhe veçantitë e nevojat e Shqipërisë;
- konceptimi, në një fazë të parë, i niveleve universitare së bashku me rezultatet e të mësuarit – Përshkruesit e Dublinit;
- konceptimi, në një fazë të dytë, i tërë niveleve të KKK së bashku me rezultatet e të mësuarit – në bashkëpunim me një tjetër grup ekspertësh të fushës para universitare.

Mbështetur në disa takime të përbashkëta dhe në atë të vetëm disa ditëve më parë, KKK integrale paraqitet ne figure.

KKK do të shkruhet në versionin e saj përfundimtar në gjuhën shqipe dhe angleze.

Deri sot janë hartuar për secilin nivel përshkruesit e Dublinit, të cilët përmbajnë:

- kandidatët që përfitojnë nga titujt sipas nivelit të dhënë,
- institucionet përgjegjëse së dhënies së titujve,
- njohuritë që duhet të mbartin titullarët,
- kompetencat e tyre,
- përparimi i tyre në formën e karakteristikave të përgjithshme në konformitet me direktivat Evropiane.

Ajo që është tipike shqiptare në KKK është niveli i gjashtë, i cili propozon të rrisë nivelin e formimit te mësuesve dhe infermierëve në përputhje me standardet dhe eksperiencat kontinentale Evropiane. Sipas saj, mendohet t'u jepet kandidatëve për tu bërë mësues apo infermier se pari një formim profesional dhe, në një faze të dytë, një formim në profesion (pedagogji apo formim spitalor). Në përfundim, atyre kandidateve që kapërcejnë me sukses provën e tere procesit formues, u jepet një dëshmi me njohje kombëtare për tu integruar ne tregun e punës.

Një detyre e rëndësishme, që del para aktorëve shqiptare të fushës, është përgatitja e kuadrit ligjor të nevojshëm për aprovimin zyrtar te KKK. Më pas, u takon të tera institucioneve shqiptare, publike dhe private, të arsimit të të gjithë niveleve, që të hartojnë librin e tyre të veçantë të kualifikimeve në përputhje me KKK dhe formimet që ato ofrojnë, duke pasur një pikë të qartë referimi tek KEK.

Së fundi, duhet të jemi optimistë, se arsimi universitar në Shqipëri do të përmbushë detyrimet për tu integruar e dinjitet dhe përfundimisht në hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë deri në vitin 2010, duke bërë të mundur lëvizjen e lirë të studentëve, pedagogëve dhe kërkuesve shqiptare brenda vendit dhe jashtë tij nëpërmjet një procesi transparent dhe të sigurt të sigurimit të cilësisë dhe njohjes së cilësdo kohe të shpenzuar për edukim dhe në cilindo nivel formimi. Brezi 2007 i studentëve të nivelit të dytë në Departamentin e Elektronikës të Universitetit Politeknik të Tiranës është baza më e fortë e këtij optimizmi.

Prof. Aleksander XHUVANI
Universiteti Politeknik
i Tiranes

Nga aktivitetet e SPASH

Eliminimi i punes se femijeve, objekt i rendesishem i punes se SPASH

Nga mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH

Ne mbledhjen e tij te dates 2 nentor 2007, Keshilli Kombetar i SPASH u ndale gjeresisht ne diskutimin e punes se bere dhe problemeve qe dalin per nje angazhim me te mire te seksioneve sindikale per eliminimin e punes se femijeve.

Mbledhja ishte konceptuar ne formen e informimeve nga disa kryetare te seksioneve, si baze per diskutime konkrete te te gjithe pjesemarresve.

Ne fillim zonja Bukuroshe Shabani paraqiti informacionin mbi punen e bere ne rrethin e Elbasanit, por sidomos ne shkollat "Ptoleme Xhuvani" dhe "De Rada", ku eshte duke u zbatuar nje program ne bashkepunim me Federaten Nderkombetare te Arsimit, EI, duke funksionuar grupe pune me mesues e nxenes dhe duke organizuar disa aktivitete konkrete per eliminimin e braktisjes se shkolles, sidomos nga femijet rome.

Ne vijim, Kryetarja e seksionit te Korces, zonja Albina Pepo, foli ne lidhje me angazhimet e ketij seksioni ne dy shkolla ne qytet dhe dy ne fshat, ne kuadrin e zbatimit te projektit me sindikatat holandeze FNV dhe AOb, si edhe ne dy shkollat e komunitetit maqedonas, ne Liqenas e Gorice, ne zbatim te nje programi me Federaten nderkombetare te Arsimit, EI dhe fondacionin holandez NOT, ku eshte duke u bere nje pune e gjithaneshme per identifikimin e nxenesve me probleme dhe monitorimin e punes se femijeve. Kerkesat per nje angazhim me te mire te mesuesve dhe sindikatave ne komunitetin maqedonas, kishin te benin, gjithashtu, edhe me nevojen e nje angazhimi me serioz te organeve te pushtetit lokal ne kete zone, sidomos per kushte me te mira pune per mesuesit, per pagesat e shperblimeve te mesuesve, te cilat nuk jane bere kurrohere ne kohe, si edhe per sigurimin e teksteve shkollore, duke i paguar autoret e tyre ne kohe.

Vemendje te vecante terhoqen aktivitetet dhe problemet e shfaqura ne shkollat e Bathores ne Tirane, per te cilat foli kryetari i seksionit te Tiranes Rreth, zoti Shaban Duka. Largimet nga shkolla ne kete zone, lidhen jo vetem me gjendjen ekonomike te familjeve, por edhe me disa koncepte konservatore te prinderve te vajzave qe jane te rritura fizikisht dhe ne disa raste pengohen te vijojne klasat e larta te shkolles 9-vjecare. Edhe Kryetari i Seksionit sindikal te rrethit te Fierit, zoti Shpetim Sino, pasi informoi mbi punen qe po behet ne kete rreth dhe sidomos ne shkollat e Levanit, Zhupanit, Mbrostarit dhe Roskovecit, nenvizoi bashkepunimin e mire midis drejtuesve te sindikatave ne keto shkolla me drejtorite e shkollave dhe kolektivin

Vijon në faqen 12

Te rritet roli i drejtuesve sindikale ne qarqe e rrethe

Nga mbledhja e Komitetit Ekzekutiv te SPASH

Mbledhja e zgjeruar e Komitetit Ekzekutiv te SPASH u zhvillua ne fryme autokritike ne lidhje me angazhimet per perballimin e detyrave sindikale ne qarqet dhe rrethet perkatese. Vemendja u perqendrua sidomos ne organizimin e nje pune me te mire per njohjen dhe zbatimin e Statutit, funksionimin e cdo njesie organizative ne shkolle, grup shkollash, rreth, qark, si institucione me drejtues serioz, qe nga kryetari, zv/kryetari, kryesia dhe Keshilli Kombetar.

Ne mbledhje u pranua se ka akoma disa te meta e dobesi sidomos ne fushen organizative, gje qe ne disa rrethe lidhet edhe me largimin e drejtuesve sindikale ne detyra te tjera dhe moszevendesimin e tyre, sipas Statutit.

Ne fjalen e vete, Kryetari i SPASH, zoti Bajram Kruja theksoi se rrethe si Durresi, Saranda, Kuksi, Bulqiza, Mirdita, Librazhdi kane veshtiresi te shumta prandaj duhen ndihmuar qe te riorganizohen sa me shpejt qe te jete e mundur.

Ne mbledhje u theksua edhe rendesia dhe pergjegjesia qe kane qarqet per funksionimin e seksioneve sindikale te rretheve perkatese. Keshtu funksionon shume mire rrethi i Elbasanit, por nuk funksionojne si duhet Peqini dhe Librazhdi. Po keshtu funksionon mire rrethi i Tiranes, por nuk funksionon si duhet Kavaja. Edhe Shkodra e Puka funksionojne mire, por ka probleme Malesia e Madhe. Me punen qe eshte bere, sidomos kohet e fundit, ne kemi permiresime te dukeshme dhe kemi shume seksione sindikale qe jane shembull, sic mund te permendim Tiranen, Korcen, Lushnjen, Lezhen, Kucoven, Gramshin, Delvinen, Tepelenen, Tropojen, Puken, Burrelin, Erseken etj.

Ne mbledhje u caktuan disa detyra, sidomos ne drejtim te punes me MASH per diskutimin e Projekt Buxhetit per vitin 2008, per shmangien e levizjeve te padrejta te mesuesve, duke zbatuar me rigorozitet edhe udhezimet e MASH, per shperblimin e mesuesve sipas Kontrates Kolektive, si edhe Vendimit per Fondin e Vecante etj.

Pervoje nga Shkodra

Zhvillimi strukturor i programit dhe kurrikulave të A.F.P. në partneritet me aktoret e pushtetit vendor

Ne hartimin dhe zhvillimin e kurrikulave ne kemi synuar qe te kemi ne qender te vemendjes trajnimin per punesim te nxenesve. Kurrikulat jane hartuar me grup pune per çdo profesion. Grupi i punes perbehet nga moderatori, kordinatori dhe ekspertet e fushes profesionale.

Grupi i punes e kryen punen ne forme bashkebisedimi. Kordinatori merret me organizimin dhe mbarevajtjen e procesit te kurrikulave. Kordinatori eshte ne lidhje me profesionet me te mundshem qe ka rrethi i Shkodres dhe ben tratativa per te marre nga firmat private kerkesat per nevojat qe ato kane per profesione te reja.

Moderatori eshte ekspert i procesit per hartimin e kurrikulave, ndjek hapat qe ben grupi i punës, pret rekomandime. Ekspertet jane te ngritur nga ana profesionale dhe japin mendime, por nuk bejne rolin e moderatorit. Moderatori mund ti beje pyetje eksperteve per efekt sqarimi te procesit te punes.

Mbas hartimit te kurrikulave me module, keto i paraqiten ekspertit profesionist. Ky ekspert nuk njeh fushen e arsimit, por eshte njohes ne profesion dhe mund te beje nderhyrjet e nevojshme.

Modeli modular nuk merr per baze permbajtjen, por kompetencat, pra nxenesi duhet te njohi proceset e punes, sepse ai ka kohe te shkurter trajnimi.

Eshte e nevojshme te studjohet tregu i punes. Tregu eshte vazhdimisht ne ndryshim e siper. Firmat duhet te jene konkuruese, ato kerkojne fuqi punëtore te afte si dhe kualifikim bashkohor. Firmat kane nje tendence qe punetoret e marrë ne pune i paguajne pak dhe nuk i regjistrojne pranë zyrave te punesimit te qarkut. Me kete metode nuk perparon teknologjia e re dhe bashkohore ,ka humbje te madhe kohe, dhe nxenesi i kualifikuar me kopetence profesionale mbetet i pa zene ne pune. Prandaj, sindikatat punojne qe aktoret e pushtetit lokal te marrin me mire situaten ne dore. Kjo do te thote; qe firmat te regjistrojne fuqine

Vijon në faqen 14

Nga aktivitetet e FSASH

T'u pergjigjemi me mire shqetesimeve te sindikalisteve

Nga mbledhja e Seksionit Sindikal te FSASH per Tiranen

Seksioni Sindikal i FSASH per qytetin e Tiranes analizoi keto dite veprimtarine permbyllese te vitit shkollor qe eshte mbyllur dhe percaktoi objektivat per vitin e ri shkollor

Kryetarja e Seksionit Sindikal te FSASH, Zj. Fatbardha Keco theksoi ne fillim hapat pozitive qe u bene gjate vitit shkollor 2006-2007, sidomos ne konsolidimin e anetaresise, ne shtimin e anetareve te rinj ne disa shkolla, sic eshte Shkolla "Ali Demi"," Kushtrimi i Lirise. "Siri Kodra" etj, si edhe ne ngritjen e keshillave sindikale te reja, sic eshte shkolla

"1 Maji", etj. Me rendesi eshte gjallerimi i jetes se keshillave dhe organizatave sindikale, ku pervec problemeve ekonomike, diskutohen edhe probleme te tjera sociale. Kane filluar te organizohen aktivitete kushtuar mesuesve te dalluar, atyre qe dalin ne pension ose veprimtari te vecanta ne kuadrin e seksionit te gruas apo te rinise.

Nje pune e mire eshte bere gjate vitit per trajnimin sindikal e profesional te drejtuesve sindikaliste dhe te mjaft mesuesve, sic eshte trajnimi per oret jashte kurrikulare qe zhvillojne mesuesit, per zgjerimin e vizionit te seksioneve te grave, etj.



Arritje perben edhe nenshkrimi i Kontrates Kolektive te nivelit te dyte, se bashku me Seksionin Sindikal te SPASH, dhe ne nje fare menyre edhe institucionalizimi i marredhenieve me Drejtorine Arsimore Rajonale te Qytetit te Tiranes.

Por, si kryetarja e seksionit, ashtu edhe kryetaret e keshillave sindikale te shkollave, qe moren fjalen ne kete takim, ngriten mjaft probleme shqetesuese qe preokupojne mesuesit sindikaliste ne shkollat e Tiranes. Ka prej ketyre problemeve, qe megjithese jane perfshire ne Kontraten Kolektive te nivelit te pare dhe te dyte, nuk njihen dhe nuk zbatohen nga punedhenesi. Tipik eshte problemi i nxjerrjes se mesuesve ne pension. Ka shume raste qe keta mesues, jo vetem nuk paralajmerohen ne kohen e caktuar qe eshte parashikuar ne Kodin e Punes dhe Kontraten Kolektive, por edhe mbasi kane punuar 15 dite ose 1 muaj mbas dates qe kane mbushur moshen e pensionit, u jepet largimi nga puna me prapaveprim, duke mos iu dhene as pagen qe u takon.

Shqetesime u ngriten edhe per transferimet e shumta te mesuesve sindikaliste nga nje shkolle ne tjetren, pa asnje motivacion dhe pa pelqimin sindikates dhe te sindikalistit punemarres. Po eshtu, emrimi i drejtuesve te shkollave, u tha ne takim, behet pothuaj pa asnje kriter.

Ne kete analize mori pjese edhe Kryetari i FSASH, Z. Xhafer Dobrushi, i cili iu pergjigj pyetjeve dhe shqetesimeve te drejtuesve sindikaliste te Qytetit te Tiranes dhe i konsideroi plotesisht te drejta verejtjet dhe shqetesimet e tyre. Ai garantoi angazhimin dhe pergjegjesine e Kryesise se Federates qe, ne bashkepunim me Seksionin Sindikal, te zgjidhin kerkesat, shqetesimet dhe problemet e sindikalisteve.

Teuta Stepa, Zv/kryetare e
Seksionit Sindikal te FSASH
per qytetin e Tiranes

Vijon nga faqja 11

arsimore, si edhe me Drejtorine Arsimore Rajonale dhe organet e pushtetit vendor ne keto zona, por nderkohe ai kerkoi me shume angazhim ne te gjita nivelet per zbatimin e Kontrates Kolektive te Punes.

Duke folur per situaten, problemet dhe angazhimet e sindikatave te shkollave ne rrethin e Shkodres, Kryetari i seksionit te ketij rrethi, zoti Aleks Dushi, vuri ne dukje nje ulje te numrit te nxenesve qe po braktisin shkollen kohet e fundit, gje qe lidhet edhe me angazhimin e sindikatave te arsimit dhe te nje numri te konsiderueshem mesuesish ne kete ceshtje. Shqetesim, theksoi ai, mbeten akoma disa zona ne Bregun e Bunes dhe ne zonen e Malesise se Madhe, por se bashku me DAR Shkoder dhe ZA Malesi e Madhe, ne po punojme per zbutjen e ketij fenomeni.

Zhvillimi strukturor i programit dhe kurrikulave të A.F.P. në partneritet me aktoret e pushtetit vendor

Vijon nga faqja 12

punetore ne zyrat e punesimit, te paraqesin prane zyrave te punesimit nevojat per profesionet e reja, t'i kerkojne pushtetit vendor nevojat që kane për të ulur papunësinë dhe njëkohësisht të koordinojnë punen me Qendren e.Formimit Profesional për të realizuar kualifikimin e tyre në përputhje me teknologjitë e reja bashkohore. Dhoma e Tregëtisë duhet te jetë partner, dhe të loze nje rol te rendesishem në këto aktivitete.

Zhvillimi i vendit, realizohet duke patur punëtor sa më shumë të kualifikuar që do të thotë:, te cilet duhet te zoertojne aftesi profesionae, njohur te gjuheve te huaja, shprehi ne pune, etj.

Ngritja e nivelit të zhvillimit ekonomik dhe permirësimi i kushteve sociale dhe të punës të qytetarëve të Shkodrës, përmbush futjen e reformave përkatëse në strategjinë dhe politikat e zhvillimit të AFP që do të cojë në uljen e papunësisë dhe varfërisë, në një përmirësim të aftësive dhe në rritjen e prodhimtarisë.

Arsimi dhe formimi profesional ne vendin tone eshte preoritet i Qeverisë..

Nëpërmjet një investimi në zhvillimin e burimeve njerëzore, vendi ynë do të rrisë mundësitë për të konkuruar dhe me vendet e rajonit e me gjere.. Ky investim do të kishte ndikim të tërthortë ndaj kushteve të pafavorshme në kuptimin e burimeve njerëzore drejt vendeve rnë të zhvilluara.

Ne jemi të ndërgjegjshëm për problemet e dyfishta të papunesisë dhe të humbjeve të aftësive. Në këto kushte është e nevojshme ngritja dhe ndërgjegjesimi i institucioneve. Mbështetja e reformave në AFP; kërkon individë me përgjegjesi dhe agjenci qeveritare të cilat të bëjnë të mundur zbatimin e politikave dhe strategjive në AFP. Në këtë mbështetje nuk duhet të harrohen në asnjë mënyrë partnerët social.

Rezultatet që priten nga ky organizim janë:

Paraqitja e studimnit të nevojave për aftësi në tregun e punës, standarteve profesionale dhe kornizës kombëtare të profesioneve si dhe programet mësimore modulare të bazuar në kopetenca. Po keshtu kerkohet :

-Formimi i metodologjise dhe instrumnenteve për gjetjen e nevojave të tregut te punës për aftësi bazuar mbi kërkesat e punëdhënësve.

-Mbledhja e kërkesave per profesione.

-Trajnimi dhe mobilizimi i stafit dhe institucione vendore për bërjen e studimeve, hulumtimeve.

-Krijimin e lidhjeve të ngushta me ndermarrje ose firma.

-Adoptimi i standarteve te reja profesiona/e.

-Prodhimi i të dhënave të besueshme mbi nevojat aktua/e dhe në të ardhmen për trajnime, përfshirë një mekanizem për përtëritjen e vazhdueshme me informaçion dhe koordinimin e të gjithë aktiviteteve përkatëse.

-Formnimi i lidhjeve të forta me komunitetin vendor, partnerë socialë, afruesit privat të trajnimeve, grupet e veçanta etj

Gjatë zhvillimit të programit të trajnimit, i bëhet një përshkrim mjedisit, paisjeve, stafit dhe tipareve të përgjithshme të programit. Nqs këto plotësohen, atëherë mund të zhvillohet trajnimi. Në zbatim të trajnimit duhet të kemi kujdes në planifikimin e trajnimit në kohë të caktuar, trajnimi të përmbledh nvënës punëtorë të kualifikuar.

Praktika është ajo që shërben për të lehtësuar perballjen e nxenesve të trajnuar me boten e punës. Trajnimi i mundëson atyre jo vetëm të kryejnë praktiken në mënyrë të rregullt, por edhe të verifikojnë edhe aftësitë e tyre, përballjen me kërkesat reale të sektoreve të ndryshëm profesional nga pikpamja teknike.

Në përgjithsi nga të dhënat që disponojnë zyrat e punës dhe te trajnimit ,arrihet në një konkluzion se në uljen e papunësisë dhe plotesimit të nevojave që ka biznesi është ndertimi i mardhenjeve midis pushtetit lokal, biznesit, shkollave profesionaleve, Q.F.P. per pregatitjen e fuqisë punetore duke realizuar pregatitjen profesionale te këtyre punonjsve. Dhoma e tregetise duhet të jetë një lidhës i të gjithë këtyre aktorve dhe njëkohësisht pjesmarrës i vlersimit të pregatitjes profesionale të kësaj fuqie punetore mbas perfundimit të trajnimit.


Me krijimin e AFP ne rrethin tone, keta aktore do të bashkëpunojnë dhe do të bashkërëndojnë punen e tyre në shërbim të biznesit në qytetin tonë, te rritjes se prodhimit e sherbimeve, ne uljen e nivelit te varferise dhe lidhjen e shkollave profesionale të të gjitha niveleve me tregun e punes.

Enis Dizdari
Pergjegjes i Praktikave Profesionale
Shkolla "Kol Margjini"
Shkoder

Të reja shkencore

Kompjuteri tani kontrollohet nga zëri

Një grup studiuesish në Universitetin e Uashingtonit kanë realizuar me sukses një pjesë programi të thjeshtë, por



intuitiv për të kontrolluar zbatimin e komandave të ndryshme në kompjuter duke përdorur vetëm dhe thjesht zërin. Kjo do të thotë se ne do të jemi në gjendje të përdorim kordat tona vokale në vend të mausit duke hyrë në veprim me programe të tjerë në internet, pa patur nevojë të kryejmë çfarëdo lloj trajnimi më parë.

Qumështi kundra stresit, sigurisht nga Japonia

Përsëri një produkt i çudishëm vjen nga Japonia, por këtë herë është një produkt natyral. Qumështi. Megjithatë, nuk është qumësht normal. Merret nga lopët një herë në javë, sapo lind dielli. Në këtë mënyrë qumështi është rreth 4 herë më i pasur se zakonisht me melatonin, i cili konsiderohet të jetë një qetësues shumë



i efektshëm për stresin. Fakti që qumështi ambalazhohet në shishe jo më shumë se 6 orë pas mjeljes ndihmon që të ruhen efektet e tij natyrale. Ajo që të lë pa fjalë për këtë qumësht është çmimi: 43 USD për 900 ml.

Shkopi Mygo mund të zëvendësojë qentë për të verbërit

Ndërkohë që qentë e stërvitur u kanë shërbyer të verbërve me besnikëri gjatë viteve a do t'i zëvendësojë ndonjëherë teknologjia? Sebastian Ritzler ka realizur një sistem interaktiv udhëzues për të verbërit, i njohur si Mygo, që vjen në formën e një shkopi të bardhë e të bukur me rrota. Ajo që e bën Mygo-n të ndryshojë nga gjithë aparaturat e tjera normale është përfshirja në sistem e një sensori "të zgjuar" dhe te nje kamere që është në gjendje të dallojë terrenin me





saktësi në kohë reale, duke lëshuar një mesazh dëgjimor në kufje.

Keshilla praktike

NËNTË FJALITE QË NUK DUHET T'IA THUASH KURRE SHEFIT

Shpesh mund te mos e dini cilat fjali duhet të mos ia përmendni kurrë shefit, në mënyrë që të mos dukeni si përtacë, të parespektueshëm ose pa takt, duke humbur shanset tuaja për të fituar një ngritje në detyrë, ngritje rroge ose edhe deri një punë më të mirë më vonë.

Ja tek janë 9 fjalitë që punëdhënësit thonë që urrejnë t'i dëgjojnë dhe pse:

1. DUHET TË FLAS ME JU PATJETER, ËSHTË E RËNDËSISHME.

Ato që për dikë mund të duken si shumë të rëndësishme për dikë tjetër mund të jenë vogëlsira. Me ritmet e shpejta të punës në kohët e sotme, menaxherët nuk kanë kohë për t'u marrë personalisht me çdo nevojë të thjeshtë të punonjësve. Nëse duhet të flisni me shefin tuaj për diçka të rëndësishme, më parë shpjegojani për çfarë bëhet fjalë.

2. NUK KAM NEVOJË TË MË MËSOJË NJERI.

Kini kujdes në këtë pikë. Ju mund të dini si të kryeni një punë, por është shumë irrituese të silleni sikur dini gjithçka dhe nuk keni asgjë për të mësuar.

3. NUK E KUPTOJ.

Tashmë është bërë e zakonshme që në momentet e para kur hyn në një punë të re të kryhet një trajnim i thjeshtë, por ai që ka nevojë për sqarime dhe udhëzime, gjithmonë, në sytë e menaxherit, mund të konsiderohet si një person i cili vlen më pak se përpjekjet që bëhen për ta perfeksionuar atë.

4. MUND TA PËRSËRISNI?

Një pyetje e falshme nëse ndodh rrallë por, nëse ju i kërkoni gjithmonë menazherit tuaj të përsërisë atë që sapo tha, tregon që ju nuk e respektoni atë duke mos e dëgjuar, ose nuk ju intereson ajo që po thoshte.

5. KJO NUK MË ËSHTË THËNË NË KONTRATË.

Vetëm në rastet kur detyra që ju kërkohet të kryeni nuk ka të bëjë aspak me vendin tuaj aktual të punës, është mirë që këtë mendim ta mbani për vete. Në ditët e sotme nuk ka asgjë që nuk mund të bëhet. Çdokush duhet të bëjë pjesen e tij në një staf, në mënyrë që puna të mos ngecë, që ndonjëherë do të thotë të kryesh edhe ndonjë punë shtesë ose të papritur.

6. MOS MË AKUZO MUA, NUK ËSHTË FAJI IM.

Diçka që është e sigurt që do ta irritonte shefin tuaj është mbulimi i një gabimi duke ia vënë fajin dikujt tjetër. Kjo sjellje i vërteton shefit tuaj që nuk jeni i besueshëm dhe nuk mund të mbështetet tek ju në të ardhmen.

7. MUND T'I THONI ATIJ TË FIKI ATË MUZIKË STRESUESE?

Nuk është detyra e shefit të zgjidhë problemet tuaja personale. Nëse nuk mund të zgjidhni vetë një problem me një kolegë, mund të pyesni shefin për një këshillë por mos prisni që ai t'u përgjigjet ankesave të tilla.

8. KAM FAMILJE UNË, PO SHKOJ NË SHTËPI.

Është e vertetë që dita zyrtare e punës mbaron në orën 5, por pak punë jashtë orarit ndonjëherë, është e zakonshme për shumë pozicione. Sigurohuni të kuptoni politikat e kompanisë për punën pas orarit para se të flisni.

9. MERRNI NJË SKLLAV MË MIRË.

Një punëdhënës mund të mbetet i shokuar nga një frazë e tillë. Edhe nëse keni vendosur të largoheni, mos e bëni këtë me fjali fyese. Ish shefi mund t'ju nevojitet për referenca në të ardhmen, prandaj është mirë të largoheni paqësisht sepse mund të pendoheni për sjellje të tilla të pakëndshme në të ardhmen.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

Tribuna sindikale

